


<i>Datë:</i> 7 Gusht 2020	
Për: Armend Zemaj, Ministër i Shëndetësisë	Nga: Lul Raka, Kryesues i Bordit Këshillëdhënës për Covid-19
RAPORT NGA MBLEDHJA E KATËRT E BORDIT KËSHILLËDHËNËS PËR COVID-19	

PËRMBLEDHJE E QËNDRIMEVE TË BORDIT KËSHILLËDHËNËS ANTI-COVID 19



- Të merren në konsideratë parashikimet e ecurisë së numrit të rasteve aktive dhe vdekshmërisë për dy javët e ardhshme (5-19 gusht) nga COVID-19 (rastet aktive nga 3908 në 5518 dhe 236 vdekje shtesë ($\pm 10\%$))
- Të përshpejtohen dhe priorizohen aktivitetet dhe procedurat nga ana e Njësisë Implementuese të projektit me Bankën Botërore (BB) në Ministrinë e Shëndetësisë. Në etapat e ardhshme të bashkëpunimit të shikohet edhe mundësia e prokurimit përmes agjencionit të tretë (UNOPS)
- Të llobohet në Kuvendin e Kosovës për ratifikimin sa më të shpejtë të marrëveshjes për bashkëpunim me BB në vlerë prej 2.1 milionë USD
- Të rriten dozat e vaksinës kundër gripit stinor dhe të përfshihen punëtorët shëndetsorë në vaksinim
- Të sigurohet buxhet për vakcina Anti-covid (OBSH ofron 20% të dozave falas)
- Parashkollorët dhe nxënësit deri në klasën e pestë të vijojnë mësimin në shkolla.
- Të hapen shkollat profesionale për mbajtjen e lëndëve profesionale dhe atyre praktike.
- Mbështet kërkesa e Federatës së Futbollit të Kosovës për nisjen e stërvitjeve për sezonin e ri, që fillon më 12 shtator.

1. Të analizohet prognoza e rritjes së rasteve aktive dhe vdekjeve nga COVID-19 për dy javët e ardhshme (1610 raste të reja aktive dhe 236 vdekje)

Me ftesë të Bordit, Z.Merkur Beqiri, ekspert ndërkombëtar i menaxhimit të informacioneve me përvojë mbi 20 vjeçare në organizatat ndërkombëtare dhe aktualisht këshilltar për Covid-19 në Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Sarajevë u ftua nga Bordi për të mbajtur një ekspozitë mbi parashikimin e ecures së pandemisë në Kosovë. Sipas tij në dy javët pasuese, numri i rasteve aktive nga 3908 do të rritet në 5518. Aktualisht shkalla e Ro është 1.7 . Në të njëjtën periudhë kohore pritet që të ketë 236 vdekje shtesë ($\pm 10\%$), respektivisht edhe 300 vdekje shtesë në muajin Gusht. Numri i vdekjeve në Kosovë e përcjell trendin e rasteve të konfirmuara pas afërsisht 19-21 ditëve. Nëse vazhdohet me trendin aktual, sipas tij, deri në fund të vitit mund të ketë deri 2000 raste të vdekjes në total. Prezentimi i tij është bashkëngjitur në raportin e mbledhjes së Bordit.



Projeksioni i mundshëm i infeksioneve aktive me COVID-19 për Kosovë në bazë të përvojave të deritanishme tek ne dhe botë si dhe në varshmëri nga sjellja e qytetarëve dhe masat tjera të aplikuara nga institucionet & komunitetet: Merkur Beqiri



2. Bashkëpunimi me Bankën Botërore në adresimin e Covid-19

Mysafire e rradhës në takim ishte Zjsh. Mrika Aliu, përfaqësuese e Bankës Botërore në Prishtinë. Ajo prezantoi portofolion e Bankës Botërore në fushën e mbështetjes së Kosovës në përballjen me COVID-19. Dokumentet përcjellëse të kësaj portofolio janë bashkangjitur me këtë raport.

Njësia implementuese e projektit me BB ndodhet në Ministrinë e Shëndetësisë. BB merr pjesë aktivisht në procedurat e prokurimit, përgatitjen e dosjes dhe specifikave të tenderimit. Sfida kryesore aktualisht është vonesa në zbatimin e aktiviteteve të parapara për shkak të vonesave procedurale administrative.

Rekomandimet e Bordit:

- **Të përshpejtohen dhe prioritizohen aktivitetet dhe procedurat nga ana e Njesisë Implementuese të projektit në MSH**
- **Në etapat e ardhshme të bashkëpunimit të shikohet edhe mundësia e prokurimit përmes agjencionit të tretë (UNOPS)**
- **Të llobohet në Kuvendin e Kosovës për ratifikimin sa më të shpejtë të marrëveshjes për bashkëpunim mes BB dhe MSH, që ndërlidhet me buxhetin e dedikuar për pajisjet e IKSHPK në vlerë prej 2.1 milionë USD**
- **Të shikohet mundësia e përfshirjes edhe të komponentës së hulumtimeve shkencore të ndërlidhura me COVID në portofolion e Bankës Botërore (hulumtimet statistikore, hulumtimet e njohurive qëndrimeve e përvojave të popullatës për COVID-19, faktorët e rrezikut për infektimin e punëtorëve shëndetsorë etj.).**

3. Bashkërenditja e aktiviteteve për pandeminë SHSKUK dhe IKSHPK

Anëtarët e Bordit ritheksuan kërkesat e parashtruara në takimet e kaluara të Bordit që ndërlidhen me SHSKUK dhe IKSHPK. Theksi i shqyrtimit u vu në këto pika:

- në trajtimin e pacientëve gjatë dy javëve të para të infeksionit,
- riorganizmin, rritjen e numrit të shtretërve dhe mobilizimin e kuadrit profesional sipas nevojës,
- sigurimin e mbrojtjes personale dhe ushqimit për stafin shëndetsorë,
- studimin e detajuar të të dhënave për vdekshmërinë,

- sigurimin e barnave (shkurtimin e procedurave për furnizim) dhe lehtësimin e kornizës ligjore për përdorimin e tyre.
- Trajnimin e shpejtë të stafit në spitalet e përgjithshme

Po ashtu, u tërheq vëmendja në fuqizimin e kapaciteteve nga klinikat dhe profesionistët e tjerë që janë shumë të afërt me pasqyrën klinike të pacientit me COVID-19. Studimet klinike kanë dëshmuar se ky virus prek shumë organe të brendshme (zemrën, mushkëritë, enët e gjakut, mëlqinë, veshkët dhe trurin). Këto fakte e bëjnë internistin shumë më të afërt për ta trajtuar një pacient me COVID-19 sesa një neurolog, i cili aktualisht merret me trajtimin e pacientëve me COVID-19.

4. Sigurimi i vaksinës kundër gripit stinor dhe përgatitjet për vaksinën kundër Covid-19

Mysafiri i tretë në takim ishte Mark Kac, ekspert i OBSH, i cili ka ardhur në Kosovë për të mbështetur kapacitet menaxheriale të pandemisë në IKSHPK dhe SHSKUK. Ai do të qëndrojë 3 javë në Kosovë. Theksi i bashkëpunimit me institucionet tona do të përqëndrohet në këto pika: triazhimi, mbikëqyrja, menaxhimi i rasteve, parandalimi dhe kontrolli i infeksioneve të punëtorët shëndetësorë dhe komunikimi i rrezikut tek popullata.

Lidhur me vaksinimin kundër gripit stinor, MSH ka porositur në Mars 100.000 doza vaksine për të rriturit dhe 5000 doza për fëmijë.

Kurse, në sfondin e përgatitjeve për vaksinën kundër COVID-19, Kosova ka nevojë për 1.2 milionë doza të kësaj vaksine. OBSH ofron 20% të dozave falas. Pjesa tjetër (900.000 doza) mbetet të blihet nga shteti dhe çmimi i përafërt mund të sillet rreth 50 dollarë për vaksinë. Fëmijët nën 12 muaj nuk vaksinohen.

Rekomandimet :

- **Të rritet numri i vaksinave kundër gripit stinor dhe të përfshihen edhe punëtorët shëndetësorë në vaksinim**
- **Të sigurohet buxhet për blerjen e vaksinave Anti-Covid**

5. Hapja e shkollave

Çështja e rihapjes së shkollave nuk është vetëm pyetje shkencore dhe teknokratike, por edhe emocionale dhe morale. Ndjenja e përgjegjësisë sonë për fëmijët është në qendër të humanitetit. Mbyllja e shkollave solli shumë pabarazi socio-ekonomike. Prandaj, çfarëdo vendimi që merret për shkollat do të jetë kompleks dhe i kontestuar.

Rikthimi i nxënësve në shkolla pas pandemisë mbetet një prej prioriteteve më të mëdha të shoqërive kudo në botë. Në shumë vende shkollat fillore janë konsideruar si shërbime esenciale të shoqërisë, madje edhe nëse ka një përhapje të moderuar të COVID-19 (<10 raste në 100.000 banorë).

Parimet e rihapjes së shkollave në Evropë dhe roli i shkollave në përhapjen e COVID-19 janë përmbledhur nga European Center for Disease Control, në botimin e 6 gushtit 2020.

Parimet themelore në kontekstin e hapjes së shkollave:

- Në Kosovë fëmijë nën 18 vjeç të prekur me COVID-19 janë X% e rasteve
- Shkalla e hospitalizimit të fëmijëve është shumë e ulët
- Fëmijët kanë kryesisht infeksion të lehtë klinik ose janë pa simptoma fare
- Sasia e virusit e gjetur te fëmijët simptomatikë është e afërt me atë të të rriturve. Por, kjo nuk nënkupton doemos infektivitetin enjejtë. Nuk dihet sa janë infektivë fëmijët asimptomatikë.
- Deri sot, shumë pak shpërthime të vatrave të infektimit me COVID-19 janë identifikuar nëpër shkollat e Evropës, përfshirë Suedinë dhe Islandën, të cilat nuk i kanë mbyllur asnjëherë shkollat fillore. Të vetmet vatra shpërthimi pas rihapjes janë regjistruar në Izrael, pjesërisht për shkak të valës së të nxehtit, me ç'rast fëmijët nuk i kanë bartur maskat gjatë tërë kohës.
- Shumica e vendeve raportojnë seroprevalencë pozitive pak më të ulët tek fëmijët sesa në grupet e të rriturve
- Hulumtimet e rasteve të identifikuar në mjediset shkollore sugjerojnë që transmetimi i infeksionit ndërmjet fëmijëve në shkolla është i rrallë dhe nuk është shkaku kryesor i infeksionit SARS-CoV-2 tek fëmijët
- Nëse zbatohen masat parandaluese (distancimi fizik dhe higjiena), shkollat nuk janë mjedise të përshtatshme të përhapjes së infeksionit. Shkalla e përhapjes nëpër

shkolla nuk dallon nga ambientet e tjera profesionale ose mjediset me dendësi të ngjashme të njerëzve.

- Ekzistojnë dëshmi kontradiktore mbi ndikimin e mbylljes / rihapjes së shkollave në nivelet e transmetimit të infeksionit në komunitet,
- Nga dëshmitë e gjurmimit të kontakteve në shkolla dhe të dhënat observuese nga shumë vende të Evropës, konstatohet se rihapja e shkollave nuk ka pasur rritje të përhapjes së virusit në komunitet.
- Dëshmitë e disponueshme gjithashtu tregojnë që mbyllja e institucioneve arsimore nuk mund të jetë masë e vetme efektive e kontrollit për transmetimin e COVID-19 në komunitet, sepse është përcjellë edhe me masa tjera parandaluese.
- Vendimet për rihapjen e shkollave duhet të jenë në përputhje me vendimet për masat e tjera të distancimit fizik dhe masave të reagimit të shëndetit publik brenda komunitetit.
- Të behet rihapja e kujdesshme e shkollave, me protokole të qarta me numër të redukuar në klasë
- Trajtimi i sektorit të arsimit duhet të jetë në koordinim me sektorët e tjerë të jetës (qendrat tregtare dhe shkollave)
- Udhëzohen komunat që të shqyrtojnë mundësinë për hapjen e shkollave edhe për nivele të tjera

Pasoja e mbylljes së shkollave. Pse duhet të hapen shkollat?

- Mbyllja e shkollave i privon fëmijët dhe të rinjtë nga mundësitë për rritje dhe zhvillim.
- Fëmijët e moshës 2-10 vjeç mësojnë shumëçka nga bashkëmoshatarët e tyre dhe kanë një ndikim pozitiv në zhvillimin e personalitetit të tyre dhe ndjenjën e identitetit, ndërsa ndërprerjet e marrëdhënieve të tilla të afërta shoqërohen me depresion, ndjenjë të fajësisë dhe zemërim të fëmijët.
- Aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore ofrojnë strukturë, kuptim dhe ritëm të përditshëm për fëmijë dhe të rinj. Për ata që vuajnë nga ankthi dhe depresioni, humbja e aktiviteteve të tilla mund të përkeqësojë simptomat dhe të forcojë tërheqjen sociale dhe humbjen e shpresës.
- Fëmijët me aftësi të kufizuara mund të preken veçanërisht pasi mund të ndjehen më të izoluar kur shkollat dhe shërbimet speciale janë të mbyllura dhe ato kanë

mundësi të kufizuara për komunikim dixhital. Për më tepër, më shumë kohë e kaluar në internet, e rrit rrezikun e ngacmimit në internet (bulizmi).

- Fëmijët që jetojnë në kushte të pasigurta dhe që vijnë nga pakicat etnike janë përballur me më shumë vështirësi me mësimin online, si për shkak të varfërisë dixhitale dhe vështirësive për prindërit që mund të ndihmojnë në procesin e të mësuarit.
- Rrethanat ekonomike mund të rrezikojnë kthimin në shkollë për fëmijë dhe të rinj që janë nën presion për të punuar dhe për të siguruar bukën për familjet e tyre të varfëra.
- Për shumë studentë që jetojnë në varfëri, shkollat nuk janë vetëm një vend për të mësuar, por edhe për ushqim të shëndetshëm, dhe për këtë arsye studiuesit paralajmërojnë se mbyllja e shkollave do të përkeqësojë pasigurinë ushqimore.
- Fëmijët kanë rrezik më të madh të dhunës në familje gjatë mbylljes së shkollës.
- Me mbylljen e shkollave, fëmijët nuk kanë më një rrjet të sigurisë që mund të zbulojë dhe raportojë abuzimin e fëmijëve, si dhe një rrjet të jashtëm shoqëror dhe mbështetjen për përballimin e abuzimit në shtëpi.
- Përtej efekteve afatshkurtra, abuzimi ndaj fëmijëve dhe neglizhenca kanë efekte afatgjata, duke përfshirë çrregullime të shëndetit mendor, infeksione seksualisht të transmetueshme, shtatzëni të padëshiruara dhe abuzim me substancat narkotike.

Rekomandimi i Bordit:

- **Parashkollorët dhe nxënësit deri në klasën e pestë të vijnë në mësimin në shkolla.**
- **Të hapen shkollat profesionale për mbajtjen e lëndëve profesionale dhe atyre praktike.**
- **Në Fakultetin e Mjekësisë, ligjëratat të mbahen online, kurse ushtrimet të mbahen nëpër klinika dhe institute të SHSKUK dhe IKSHPK. Të merret në konsideratë edhe ndihma e absolventëve të FM në përballje me COVID-19.**

<https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/COVID-19-schools-transmission-August%202020.pdf>

6. TË TJERA

- Bordi mbështet kërkesën e Federatës së Futbollit të Kosovës për nisjen e stërvitjeve përgatitore për sezonin e ri, i cili fillon më 12 shtator.
- Bordi përkrah nismën e validimit të testit me nanoteknologji në Kosovë nga Universiteti “Ben Gurion” i Izraelit
- Anëtarët e Bordit kërkojnë nga Ministri që të përfshihet më shumë në zbatimin e rekomandimeve të Bordit nga takimet e kaluara dhe të ketë një komunikim të afërt me të.